



C.nr.284/15

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ-** Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtësen Minrie Krasniqi, ne ceshtjen e inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime, kunder te paditurit [REDACTED] nga Ferizaj rr.' [REDACTED] per vertetim pronesie, jashtë shqyrtimit kryesor me datën 31.10.2016 merr kete:

**A K T G J Y K I M**  
**- ne baze te pohimit -**

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime, dhe **VËRTETOHET** se paditësi është pronar i paluajtshmerisë me numër të njësisë kadastrale **P-72809015-00036-0**, vendi i quajtur "Fusha Binake", me sipër. 11477m<sup>2</sup>, zona kadastrale Vojnov ZK Shtime.

**OBLIGOHET** i padituri [REDACTED] nga Ferizaj rr.' [REDACTED] trashëgimtari ligjor i te ndjerit [REDACTED] që paditësit t'ia njohin te drejtën e pronësisë mbi këtë pronë dhe të lejojë regjistrimin e saj ne regjistrat kadastral në emër të paditësit, këtë në afat prej 15 ditësh pas pranimit te kopjes së tij, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërben paditësit si autorizim për të bërë regjistrimin e pronës në emër të tij.

**OBLIGOHET** paditësi që të bëjë pagesën e taksë për padi dhe aktgjykim ne shume prej 75€, ne afat prej 15 ditesh pas pranimit te ketij aktgjykimi.

**A r s y e t i m i**

Paditesi me padi ka pretenduar se gjatë viteve të '70-ta, në bazë të marrëveshjes gojore, në prezencë të dëshmitarëve nga babai i të paditurit tani i ndjeri [REDACTED] ka blerë pronën kontestuese P-72809015-00036-0, vendi i quajtur "Fusha Binake", me sipër. 11477m<sup>2</sup>, në zonën kadastrale [REDACTED] për çmimin rreth 2milion dinarësh (çmimi i tanishëm 3,000€), të cilin çmimin e ka përmbushur në tërësi dhe të njëjtën pronë e ka marrë menjëherë në posedim dhe që nga ajo kohë është duke e shfrytëzuar i pa penguar nga askush dhe të njëjtën vazhdon ta posedoj dhe shfrytëzoj akom. I cili ka kerkuar t'i njihet e drejta e pronesise mbi bazen e shitblerjese dhe të posedimit me mirebesim.

Gjykata, pasi qe ka shqyrtuar shkresat e lendes, ka obliguar te paditurin qe te parashtron pergjigje ne padine e paditesit. I padituri ne pergjigjen e saj ne padi, e cila është pranuar në gjykatë me datën 25.10.2016, ka theksuar se padia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar, dhe se te njëjtën nuk e kundërshton, për faktin se babai i tij tani i ndjerë [REDACTED] në vitin 1969, në kohë kur jemi shpërngulur për Maqedoni, këtë paluajtshmeri i'a ka shitur paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] për çmimin prej 2milion dinarësh të atëhershëm, dhe se të njëjtën paluajtshmeri e ka paguar në tërësi dhe menjëherë e ka marrë në posedim. Po ashtu ka theksuar se në kohën kur është bërë shitblerjese e kësaj paluajtshmerie i njëjti ka qenë 27 vjeç dhe se kjo rrethan i kujtohet shumë mirë, ndërsa sa i përket çmimit të shitblerjes ai ka deklaruar se i kujtohet shumë mirë që është paguar në tërësi, pasi që ai dhe vëllau i tij tani i ndjerë [REDACTED]

kanë qenë dëshmitarë kur është bërë kjo shitblerje dhe se me të hollat e kësaj shitblerje ai dhe vëllau i tij kanë blerë paluajtshmërinë në fshatin [REDACTED] të Maqedonisë. Andaj nga deklaratimet e tij i njejtë ka theksuar se nuk e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit, ngase nuk ka asnjë fakt aoi rrethanë kontestuese.

I padituri me datën 03.11.2016 në Zyrën Noteriale Noter [REDACTED] në Ferizaj, ka dhënë Deklaratë Nën Betim, me anë të së cilës ka deklaruar se është trashëgimtar ligjor i të ndjerit [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime, me vendbanim në Shkup Republika e Maqedonisë ku dhe ka ndërruar jetë. Me anë të së cilës deklarata ka vërtetuar faktin se është trashëgimtar ligjor i [REDACTED] i cili është i shënuar si pronar i njësisë kadastrale e cila është objekt kontesti.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të pohuar duke qenë se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se i padituri përmesë përgjigjes në padi e ka pranuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e cila do të pengonte aprovimin e kërkesëpadisë dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadisë nga e të paditurit, ndaj në kuptim të nenit 148 të LPK-së, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata pas shqyrtimit të shresave të lendes dhe pretendimeve të cilat ka parashtruar i padituri në përgjigje në padi, ka gjeturë për shkak të ekonomizimit të procedurës nuk është e arsyeshme të lëshohet në shqyrtim gjyqësor të kësaj çështje, andaj në bazë të ketyre provave dhe fakteve të cilat i ka paraqitur i padituri në përgjigjen në padi është ka gjetur se nuk ekzistoj ndonjë faktë kontestues në mesë palëve ndërgjyqëse dhe si rezultat i ketyre fakteve padia e paditësit ka rezultuar e themelt.

Gjykata e ka ngarkuar paditësin me shpenzimet e procedurës dhe atë taksën padi dhe aktgjykim në shume prej 75€, në bazë të UA nr.2008/2 të KGJK-se, për unifikimin e taksave gjyqësore.

Mbi bazën e parashtrimeve të mesiperme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**  
**C.nr.284/15, me datën 31.10.2016**

**Gjyqtari,**  
**Enes Mehmeti**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kunder këtij aktgjykim mund të ushtrohet ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në gjykatën e Apelit të Prishtinës, përmes kësaj gjykate.

